



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:105565

Datë: 27.09.2019

Numri i dokumentit: 00537370

C.nr.1014/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Mirvete Alidemi, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani- Rahimi, duke vendosur në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit R.H. nga , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat nga , kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson juristi nga , për kompenzimin e pagave jubilarë dhe percjellëse në pension, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike me datën 18.09.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET - në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.H. nga , e ushtruar ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria e Arsimit në Gjilan dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Arsimit, që paditësit R.H. nga t'ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar për 40 vjet 6 muaj e 27 ditë të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, respektivisht shumën prej 631.50€ si dhe tri (3) pagesa mujore për percjellje në pension në shumën prej 1.382,40 €, me kamatë ligjore prej 8% ne vit, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. OBLIGOHET e paditura që t'ia kompensoj paditëses shpenzimet e procedurës në shumën prej 270€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm,

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompenzimin e pagave për percjellje në pension dhe për shpërblim jubilar, duke theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënës në ciklin klasor në Shkollën e Mesme të Ulët , kur edhe i ka përfunduar punësimi sipas fuqisë së ligjit gjegjësisht Aktvendimit për Nderprerjen e Marrdhënies së Punës me numer 23336 të dt.09.03.2018 dhe gjatë kohës sa ka qenë mësimdhënës ka pas përvojë pune 44 vite 6 muaj e 27 ditë , më tutje i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv sa i përket vlerës së kontestit , ashtu që kërkesëpadia e paditësit të jetë kompensimi i pagave percjellëse prej 3 pagave mujore në vlerë prej 1,382.40€ si dhe një page bazë për shpërblim jubilar në shumë prej 631.50€ me kamatë ligjore –vjetore prej 8%,nga data e ushtrimit të padisë, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës edhe atë: 104€ për përpilimin e padisë, 135€ për seancë dhe 31 € për pagesën e taksës gjyqësore.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e paditësit, e paditura ka ushtruar përgjigje në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës si të pa bazuar dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar. Po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë përgjegjës në padi.

Gjykata për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për ta vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: aktvendimi për nderperjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së Ligjit me numer të protokollit 23336 të dt. 09.03.2018, vërtetimin për përvojën e punës të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Ulët në me nr. të protokollit 33/18 i dt. 28.03.2018, përgjegjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit me të cilën është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit të dt. 03.05.2018, me numër të protokollit 37430, pasqyren e bankës të lëshuar nga në Gjilan.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Nga aktvendimi për nderperjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së ligjit me numër të protokollit në 23336 të dt. 09.03.2018 në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënës i ciklit klasor, pranë në dhe të cilit i është nderpererë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit me dt.28.03.2018.

Nga vërtetimi për përvojën e punës të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, gjykata vërtetoi faktin se për paditësin është dëshmuar përvoja e punës për 44 vite 6 muaj e 27 ditë.

Nga përgjegjja e drejtorisë komunale të Arsimit, gjykata vërtetoi se nga kjo përgjegje është refuzuar për kompensimin e pagave të kërkuara me numër të protokollit 37430 e datës 03.05.2018.

Nga pasqyra e bankës në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se paditësi për muajin Dhjetor të vitit 2017 ka realizuar të ardhura mujore në shumë prej 447.02€, ndersa për muajin Janar dhe Shkurt të vitit 2018 ka realizuar të ardhura mujore në shumë prej 460.80€.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë/ dt.18.04.2017, (e cila ka hyrë në fuqi menjëherë), konkretisht nenin 35 par.8, pika 8.4 dhe paragraf 9, pika 9.1 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që kërkesëpadia e paditësit të aprovet si e bazuar dhe të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtorja Komunale e Arsimit në Gjilan, që paditësit, t'ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar për 44 vite 6 muaj e 27 ditë pune 1 pagë bazë në vlerë prej 631.50€ dhe 3 paga përcjellëse në vlerë prej 1.382.40€, me kamatë ligjore –vjetore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kjo nga fakti se në nenin 35 par. 8, shprehimisht është përcaktuar se “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë ku pika 8.4 parasheh: ” Për 40 vite të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë”, poashtu në paragraf 9 të kësaj kontrate shprehimisht thuhet” Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse sipas mesatares së tri (3) pagave të fundit të punëtorit”.

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*” kurse lartësia e kamatë vonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II-të të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 452.2 të LPK-ës, ashtu që e detyroj palën e paditur që t’ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore edhe ate, për një seancë të mbajtur shumë prej 135 € si dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 31 euro, si dhe ne emer të prëpilit të padisë shumë prej 104€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 270 €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Nga të lartcekurat më lartë, e konform nenit 35.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e cila është në fuqi që nga dt.18.04.2017, si dhe nenit 382 të LMD-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 1014/18, më datë:18.09.2019

Gj y q t a r j a ,
Mirvete Alidemi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën së Apelit në Prishtinë, ndërsa ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.